



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

-Shërbimi i Kuvendit-

01/Nr. 60/01-15123/19
Kaçanik, 30.05.2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **V (Pestë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur me, 30 Maj 2019. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 25 anëtarë, në ndërkohë arritën anëtarët, Kadri Krivenjeva dhe Lirije Shurdhani, kështu që konstatohet se pjesëmarrës të këtij takimi ishin 27 anëtarë- të gjithë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive: Ramadush Osmani, Bahri Selimi, Fatmir Loku, Ukshin Qallaku dhe Festim Neziraj, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Bujar Bajra, Fatlume Guri-Selimi, Iliriana Berisha dhe Arbnora Kuka.

Nga OSBE, mbledhja u monitorua nga, Faruk Dërmaku dhe Gazmend Murseli.

Mbledhja u monitorua përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Makfirë Malsiu, Zyrtarë e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin duke i thirrur emër për emër të gjithë anëtarët e KK. Pjesëmarrës në mbledhje janë, 25 anëtarë, ndërkaq 2 anëtarë pritët të vijnë në ndërkohë, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi Mbledhjen e V të Rregullt të Kuvendit të Komunës, për vitin 2019, data 30 Maj, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Plani i Reagimit Emergjent për Komunën e Kaçanikut;
3. Rekomandimet e Komisionit për përzgjedhjen e ofertave ekonomike me të favorshme për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës;
4. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas Ligjit të ri në fuqi, Nr. 06/L-092;
5. Propozim Vendimi për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01/Nr. 16-9103/14 të datës 31.03.2014;

6. Propozim Vendim për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 104/02-8061/19 të datës 29.03.2019- Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të ri shkollor në f. Doganaj; dhe
7. Propozim Vendimi për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 400/01-11745/19 i datës 30.04.2019- për transferin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2019 në kategorinë ekonomike, Paga dhe Mëditje.

Lidhur me rendin e propozuar të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë, Rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Rendin e Punës në përbërje prej 7 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës:

Procesverbali i mbledhjes së IV-të (Katërt) të Rregullt i Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri me një vërejtje të Shpend Krusha të pozicioni, Pyetje dhe Kërkesa, e cila vërejtje do të korrigjohet nga Shërbimi i Kuvendit dhe Procesverbali do të publikohet i përmirësuar. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja e IV-të (Katërt) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2019 të datës 30 Prill 2019. / Lënda: 01Nr. 060/03-12154/19.

Kryesuesi i Kuvendit, Para se me kaluar në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave, kërkoj që pas përfundimit të mbledhjes, shefat e grupeve parlamentare të mbledhen në Zyrën time për debatimin e çështjes së dëmtimit dhe shkatërrimit të pyjeve të komunës e në veçanti, pjesën pyjeve të Malit të Sharrit, ndërkaq shtoj së, nëse është nevoja në mbledhjen vijuese të marrim ndonjë vendim. Në vazhdim Kryesuesi theksoj se kam debatuar edhe deputetin e Kuvendit të Kosovës nga Komuna e Kaçanikut, z. Lutfi Zharku, dhe ai u pajtua me debatuar këtë çështje, ndërkaq konstatoj me kaluar në pozicionin;

Pyetje dhe Kërkesa

z. Ekrem Kyçyku, Nga banorët e f. Llanishtë kam një Kërkesë që të lidhen me rrugën "Mejdi Dalloshi", sepse lidhja më këtë rrugë është në të mirë të qytetarëve të asaj pjese.

znj. Arlinda Rakoci-Raka, Me intereson të di për vendimin për drejtor të Çerdhes së Fëmijëve QEAP " Agimi" në Kaçanik, përse për inatet e juaja personale nuk e thirrni me dal në punë drejtoreshën e cila e ka fituar gjyqin. Dihet se tani është afër 1 Qershori- Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, ndërkaq asnjë organizim nuk është bërë në mungesë të drejtoreshës së Çerdhes. Me intereson të di Kryetar, përse nuk e zbatoni vendimin e Gjykatës për me kthyer në punë drejtoreshën e Çerdhes së fëmijëve. Me fitimin e kontestin gjyqësor të drejtoreshës së Çerdhes së fëmijëve, unë kujtoj së ju e keni dëmtuar buxhetin e komunës. Përgjigjen në këtë pyetje unë e kërkoj të më jepen tani për tani.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Lidhur me pyetjen e znj. Arlinda Rakoci-Raka, e ftoj zonjën në Zyrën time për me marrë përgjigje.

z. Bekim Koxha, Edhe Unë po lidhem më pyetjen e Arlindës lidhur me drejtoreshën e Çerdhes së fëmijëve QEAP” Agimi në Kaçanik”, Unë nuk e di arsyen përse Kryetari i Komunës nuk e kthen në punë drejtoreshën e Çerdhes së fëmijëve e cila e ka fituar kontestin gjyqësor.

Kryetari i Komunës, Unë po e zbatoj një Vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Kosovës-organit më të lartë ekzekutues. KPM është organ ekzekutiv më i lartë i cili e mbikëqyrë punën time. Unë i kam dy vendime legjitime nga 2 organe, ndërkaq kam kërkuar nga Gjykata e Apelit se cilin nga dy vendimet me e zbatuar.

Kryesuesi i Kuvendit, I bëni pyetjet, pastaj i merrni përgjigjet me shkrim. Nëse keni dashur me debatuar për këtë çështje, atëherë është dashur me futur si pikë në rend pune.

znj. Afërdita Horuni, Pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve publike dhe Emergjencës; E dimë që shume herë është ngritur çështja e barrierave në rrugën “Emsale Frangu”, mirëpo ende nuk keni ndërmarrë masa ! Me intereson ta di, ku ka ngecë puna e kësaj çështje, pasi që rruga është shumë e kalueshme dhe është një pasiguri e madhe për fëmijët?

z. Adnan Reka, Periudha e Ramazanit ishte një sinjal i mirë për t’na treguar gjendjen e komunikacionit rrugor në qytet. Nuk jemi larg periudhës kur si zakonisht presim të na vijnë mërgimtarët tanë dhe të shtohet fluksi i veturave në komunikacion. Ne kërkojmë që të hartohet një Plan paraprak që të menaxhohet me kohë situata e parkingut dhe qarkullimit të lirë të veturave në Komunën e Kaçanikut.

z. Bekim Koxha, Rruga për të Stanet është në gjendje të mjerueshme. Me pasur mundësi me marrë veprime të nevojshme për rregullimin e asaj rruge- shtrimin së paku me zhavorr të rrugës deri të stanet, do të ishte mirë.

z. Besim Vishi, E kam një Kërkesë nga qytetarët e f. Dubravë, për vendosjen e policëve të shtrirë në rrugën e Dubravës, sepse po ka vozitje të shpejta, ndërkaq kemi kyçje në rrugë të shkolla dhe në lagjen Vishaj që nuk kanë asnjë pengesë në rrugë të cilët paraqesin rrezik për qytetarët e asaj ane.

2. Ndriçimi publik po bëhet nëpër rrugën kryesore të fshatit Dubravë, ndërkaq po e lënë pa ndriçim publik lagjen apo vendbanimin. Është mirë të ndërrohet qasja e projektit të ndriçimit publik, ashtu që ndriçimi publik të bëhet brenda lagjeve.

z. Ramadush Osmani- drejtor i DSHPE. Përgjigje në pyetjet e Besim Vishi- Çështja e barrierave bien në shërbimin e drejtorisë që udhëheqim unë, ndërkaq çështja e ndriçimit publik, bëhet përgjatë rrugës së Dubravës dhe në atë rrugë gravitojnë edhe qytetarët e lagjes suaj.

z. Shpend Krusha, Qeveria e Republikës së Kosovës mori vendim për lejimin e të 2 kyçje-ç kyçje në autostradën, Prishtinë-Shkup për dy qytete të Kosovës, ndërkaq ne si Kuvend i Komunës patëm Kërkesë për lejimin e 1 kyçje-ç kyçje në qytetin e Kaçanikut. I falënderoj anëtarët e KK që e përkrahën kërkesën tonë (LVV), ndërkaq kërkesa e adresuar në emër të Kuvendit të Komunës për një kyçje-ç kyçje në autostradë në afërsi të qytetit të Kaçanikut nuk u aprovua në nivel qendror si rezultat i neglizhencës së organeve të komunës. Unë kam kërkuar që të formohet një delegacion për një takim me strukturat e nivelit qeveritar për këtë çështje, dhe ju kryetar i keni përfaqësuesit e partisë së juaj në pushtet. Për mendimin tim, kjo është neglizhencë dhe mosinteresim i Kryetarit të Komunës.

Ne si komunë në këtë formë vetëm po dëmtohem, sepse nuk do të kenë interesim me vizituar komunën tonë qytetarët e Kosovës e as të huajt. Më intereson të di, cilat janë masat që do t’i merr komuna jonë në këtë drejtim. Ju drejtohem juve Kryetar, për arsye se je i

zgjedhur me i mbrojtur të drejtat e qytetarëve të komunës sonë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kryetari i Komunës, Kërkesa në emër të Kuvendit të Komunës është hartuar nga përfaqësues të subjekteve politike në KK dhe e njëjta iu është dërguar organeve relevante, ndërkaq ndonjë përgjigje në atë kërkesë nuk kemi marrë.

Çështja për me formuar një grup punues lidhur me kërkesën për me biseduar me organet relevante të nivelit qendror, kjo nuk është bërë. Arsyeimi i ministrit të Infrastrukturës ka qenë së, nuk ka mundësi Komuna e Kaçanikut me pasur tjetër qasje në autostradën. Prishtinë-Shkup. Çdo kush që ka protestuar për një çështje të caktuar, si Kryetar i Komunës i kam dal në përkrahje, ndërkaq ju nuk keni marrë ndonjë veprim për me qëndruar pran kërkesës tuaj.

z. Shpend Krusha, Kuvendi i Komunës e ka iniciuar kërkesën për kyçje – ç kyçje, mirëpo kërkesës tonë nuk i keni dal në mbrojtje kryetar. Unë më së paku tri herë në emër të LVV e kam ngritur këtë çështje në Kuvendin e Komunës.

z. Nexhat Loku, Për mos me zgjatur këtë temë, propozoj që, Çështja e lejimit të një kyçje-ç kyçje në Autostradën, Prishtinë- Shkup, të hynë në rend pune në mbledhjen vijuese të KK në mënyrë që të debatojmë këtë çështje.

z. Bekim Koxha, Lidhur me Kërkesën e KK për kyçje - ç kyçje, nuk është bërë asgjë në këtë drejtim, kështu që edhe unë pajtohem me propozimin i cili doli që kjo çështje të debatohet në mbledhjen vijuese të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kërkesa të tjera, përgjigjet do t'i merrni nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhjen vijuese të Kuvendit të Komunës, atëherë procedojmë me pikët e radhës të rendit të punës;

2. Plani i Reagimit Emergjent për Komunën e Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, para se më hapur diskutimin në këtë pikë, fillimisht fjalën e ka drejtori i DSHPE, Ramadush Osmani.

z. Ramadush Osmani, Theksoj së në këtë plan janë përcaktuar detyrat të secilit zyrtar për realizimin e tij. Plani aktivizohet në bazë të informatave që paraqitën në raste të caktuara për intervenime emergjente. Janë dhënë detajet për zyrtarët që janë të ngarkuara me detyra, mënyra sesi aktivizohet si dhe zingjiri komandues, kapacitetet kadrovike dhe makinerie në nivel komune për vendet që mund të paraqesin rrezik si, Urat. Lumenjtë, strehimoret që do të përdoren në rast rreziku etj. Prezent në mbledhje është edhe zyrtari kryesor që marrë pjesë në hartimin e këtij plani, Bujar Bajra, i cili sipas nevojave mund të jap sqarime me në detale rreth këtij plani.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjuat sqarimet e drejtorit në këtë plan, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin;

z. Ekrem Kyçyku, Plani është shumë voluminoz, ku janë paraqitur të gjitha detyrat që dalin në rast të rreziqeve që mund të ndodhin. Të Shtëpia e Mallrave janë dy Strehimore të Luftës së Dytë Botërore të cilat strehimore nuk janë futur në listë. Këto strehimore mendoj se me pak mjete buxhetore mund të vihen në funksion të shërbimeve emergjente. Të bizneset, shihet se janë futur vetëm 7 biznese në këtë plan, ndërkaq komuna ka shumë biznese të tjera

të cilat duhet të jenë në listë. Të sistemi i alarmit, sa e di unë, Komuna e Kaçanikut nuk ka sistem të alarmit.

z. Adnan Reka, Unë do të doja që ne sot të rishqyrtojmë Plan e Reagimit Emergjent të deri tanishëm pra se ta miratojmë një plan të ri. Do të thotë ne nuk paskemi pasur fare Plan Emergjent. Tani unë po e kuptoj pse ju nuk keni reaguar vitin e kaluar kur kishim vërshime në Komunën tonë dhe si pasojë mbeti rruga kryesore e mbyllur për më shumë se dy javë. Ky Plan i Reagimit Emergjent mund të duket i mirë në letër, por ne shpresojmë që plani do të jetë i zbatueshëm në teren në situata emergjente e të mos na ngelin banorët e ngujuar nëpër shtëpi apo rrugët e bllokuara me javë të tëra.

z. Bekim Koxha, Është mirë më bërë një provë paraprakisht, për me ditur se si po funksionon ky Plan i reagimit emergjent.

z. Selim Reka, Edhe në mbledhjen e KPF unë i kam dhënë vërejtjet e mia mbi evidentimin e rreziqeve nga faktori natyror dhe ai shoqëror, si të përrrenjtë në rast të vërshimeve, në mënyrë që të rregullohen ato para se të ndodhë rreziku, sepse edhe dëmet mund të jenë më të vogla. Ka mungesë të trotuareve, urave, hidrantëve, pastaj mjeteve kundër zjarreve në institucione nuk iu ka bërë ndonjë kontroll se a janë në rregull, mungesa e shkallëve emergjente në objekte publike etj. Të strehimoret, a është bërë ndonjë analizë e tyre për me ditur se a janë të gatshme për me i përdorur në raste të rreziqeve.

z. Shpend Krusha, Me intereson të di, a është paraparë ndonjë Fond emergjent vjetor për realizimin e Planit të reagimit emergjent.

z. Besim Vishi, Të Komiteti i reagimit emergjent, shihet se janë përfshirë drejtorët e drejtorive komunale, ndërkaq nuk janë përfshirë dikush nga KEDS, kur dihet fakti se hapi i parë i cili duhet merret reagues në raste rreziku, gati çdo herë është ndërprerja e energjisë elektrike. Unë kujtoj se faqja 41 të KEDS duhet të ndryshohet dhe plotësohet.

z. Ramadush Osmani, Ky është një udhërrëfyes sesi duhet të punohet në rast të rreziqeve. Sektorët i kanë detyrat e përcaktuara në plan, të detyrat është i përfshirë edhe KEDS. Në vërejtjet e juaja do t'ia përcjellim grupit punues, në mënyrë që me marrë veprime për përmirësimin e tyre. Fond emergjent komuna nuk ka, sepse nuk iu lejohet komunave me pasur fond emergjent. Fondi emergjent është në nivel qendror, ndërkaq iu shpërndahet komunave sipas kërkesave dhe nevojave. Kërkesa jonë është me pasur komuna fond emergjent sidomos për shtëpitë të cilat po digjen. Organet kompetente bëjnë stërvitje të mjaftueshme për me qenë të përgatitur për raste emergjente, ndërkaq sistem të alarmit nuk ka komuna, alarmuesi i parë është Policia e Kosovës.

z. Bekim Koxha, A janë paraparë rezerva të ushqimit në raste të shkaktimit të rreziqeve.

z. Ramadush Osmani, Po, rezerva të ushqimit në raste të shkaktimit të rreziqeve është paraparë të menaxhimi i resurseve njerëzore.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë Plan veprimi e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë.

VENDIM

Për Aprovimin e Planit të Reagimit Emergjent për Komunën e Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 07-104/02-14934/19.

3. Rekomandimet e Komisionit për përzgjedhjen e ofertave ekonomiksht me të favorshme për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës:

Kryesuesi i Kuvendit, Për hera të tjera kur Komisioni për vlerësim duhet t'ia dërgoj Kuvendit të Komunës kriteret e ofrimit, vlera e investimit e ofertuesit të propozuar më të favorshme, përfitimi i komunës, sa është numri i të punësuarve e kështu me radhë. Megjithatë nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Ekrem Raka, Unë mendoj se dhënia në shfrytëzim e pronës komunale për 40 vite është shumë. Me pasur mundësi me i dhënë këto prona komunale për 20 vite në shfrytëzim me mundësi vazhdimi edhe për 20 vite të tjera kujtoj se do të ishte më mirë.

Kryesuesi i Kuvendit, Të dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronave komunale, nëse investuesi mendon me investuar shumë në atë pronë, atëherë nuk hynë me marrë pronë komunale në shfrytëzim për afat të shkurtër. Në sipërfaqen e cila do të jepet në shfrytëzim janë disa prona mangët, pasi do të ndërtohet një rrugë, kështu që ajo pjesa e rrugës nuk do të jepet në shfrytëzim. Meqë nuk ka diskutime të tjera, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 24 votë Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 2 anëtarë: Ekrem Raka dhe Bekim Koxha, ndërkaq anëtarja Hafize Sallahi nuk ishte në sallë kur u votua kjo çështje. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për miratimin e Rekomandimeve të komisionit vlerësues (Shkresa përcjellëse 01Nr.060/01-14677/19)- Për vlerësimin e ofertave ekonomiksht me të favorshme për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë- për 40 vjet këtyre kompanive, sipas Konkursit publik Nr. 01/2019 të datës 20 Mars 2019:

1. I jepet në shfrytëzim afatgjatë-për 40 vjet, Kompanisë shërbyese dhe veprimtari të tjera N.T.P. "Muja" me pronarin, Muhamet Zenuni nga f. Duraj i Komunës Kaçanik, Nr. i rexhistrit të biznesit, 80124163 me aktivitet të biznesit, shërbime dhe veprimtari të tjera, këto Parcela Kadastrale:

-Parcela Kadastrale me Nr.P- 70917026-00124-0, PSH. K.K. Kaçanik, me kulturë kullosë e klasës së 5 (pestë) në vendin "Kaliman Vore të Tenes" Zona Kadastrale Doganaj-Kaçanik, në sipërfaqe e aprovuar, 4218m², në kuadër të sipërfaqes së përgjithshme 4601m²; si dhe

- Parcela Kadastrale me Nr. P-70917021-00217-0 P.SH.K.K. Kaçanik, në vendin e quajtur "Kërdhak -Toska" Zona Kadastrale Gërlica e Epërme- Kaçanik në sipërfaqen e aprovuar 1356m² në kuadër të sipërfaqes së përgjithshme 9413m² / **Lënda me numër të Aplikacionit, 01Nr. 104/02-0013410/19.**

2. I jepet në shfrytëzim afatgjatë-për 40 vjet, Kompanisë prodhuese, shërbyese tregtare, N.T."X-PLAST" në emër të Nexhat Vogliqi nga f. Gërlicë e Epërme, Nr.i rexhistrit të biznesit, 70880318 nga f. Gërlica e Epërme, Komuna e Kaçanikut, Parcela me Nr. P-70917021-00217-0 në sipërfaqen 6608m², PSH. KK Kaçanik, në vendin, "Kërdhak Toska" Zona Kadastrale Gërlicë e Epërme- Kaçanik, në kuadër të sipërfaqes së përgjithshme 9413m², për zgjerimin e biznesit, hapjen e një fabrike prodhuese të tekstitit (rrobaqepësisë), vlera e investimit, 130000€(njëqind e tridhjetë mijë euro) me qëllim të krijimit të punësimeve të 35 punëtorëve, kryesisht punësimeve femra. / **Lënda me numër të Aplikacionit, 01Nr. 104/02-0013023/19.**

4. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas Ligjit të ri në fuqi, Nr. 06/L-092:

Kryesuesi i Kuvendit, Me aprovimin e Ligjit të ri për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronave komunale, duhet të formohet edhe Komisioni i ri. Me këtë ligj komisioni duhet të jetë në përbërje prej 5 anëtarëve, 2 anëtarë nga Kuvendi i Komunës, 2 anëtarë nga Ekzekutivi i Komunës 1anëtar nga OJQ. Nëse nuk ka kush diçka, atëherë shkojmë me propozime konkrete për 2 anëtarë nga KK nga 2 subjektet politike me të mëdha, nëse nuk keni ndonjë propozim tjetër.

Nga PDK, Nexhat Loku, e propozoj për anëtar të komisionit, Kadri Krivenjeva.

Nga LVV, Ekrem Kyçyku e propozoj për anëtare të komisionit, Kaltrina Tafili.
Propozimet të cilat dolën u shtruan në votim dhe të njëjtat u aprovuan njëzëri nga anëtarët të cilët ishin prezentë në sallë. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas Ligjit të ri në fuqi, Nr. 06/L-092, në përbërje:

- 1, Kadri Krivenjeva anëtar nga KK ,
2. Kaltrina Tafili, anëtare nga KK,
3. anëtar nga Ekzekutivi i Komunës,
4. anëtar nga Ekzekutivi i Komunës, dhe
5.anëtar nga OJQ

Anëtarët nga Ekzekutivi i Komunës caktohen nga Kryetari i Komunës, ndërkaq anëtari i 5 propozohet nga OJQ / Lënda: 01Nr. 104/02-14800/19.

Nga Ekzekutivi i Komunës për anëtarë Komisionit janë caktuar, **Besnik Bajra dhe Remzi Shabani**, ndërkaq nga OJQ është caktuar, **Zekirja Elezi**.

5. Propozim Vendimi për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 16-9103/14 të datës 31.03.2014;

Kryesuesi i Kuvendit, Sqaroj se duhet të hiqet vetëm fjala “Këmbim” e atij vendimi, sepse pronat shoqërore nuk mund të këmbehen. Nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin:

z. Ekrem Raka, Çdo Propozim Vendim që na adresohet, duhet të vjen i kompletuar. Më herët sa e di unë, Komuna nuk ka pasur të drejtë me i shpronësuar pronat të cilat kanë qenë në menaxhim të AKP, ndërkaq tani nëse është e lejuar me u shpronësuar pronat e AKP, më intereson ligji i cili lejon shpronësimin e tyre.

z. Ukshin Qallaku, Sqaroj për pronat të cilat janë të shpallura me u shpronësuar të cilat janë në menaxhim të AKP, ndërkaq është ligji për shpronësimin e pronave i cili ligj nuk e ndalon shpronësimin e pronave shoqërore që menaxhohen nga AKP.

Kryesuesi i Kuvendit, Me ligjin e ri, pronat e AKP që janë në interes të komunës mund të shpronësohen, sepse qeveria ka marrë vendim që pronat që janë në interes të komunës të mund të shpronësohen.

z. Bekim Koxha, Çka do të bëhet me çështjet pronësoro juridike të pronave në “Çardak”, kur dihet së lëndët për këto prona janë në Gjykatë.

Kryesuesi i Kuvendit, Ato prona që kanë masa sigurie, mund të procedohen, ndërkaq ato të cilat nuk kanë masa sigurie besoj se nuk procedohen. Meqë nuk ka diskutime të tjera, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për. Kundër votë nuk pati. Abstenuan 7 anëtarë, ndërkaq anëtarët, Hafize Sallahu dhe Lirije Luta nuk ishin në sallë kur u votua kjo çështje. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë.

VENDIM

Për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 16-9103/14 të datës 31.03.2014 – për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për ndërtimin e stadiumit të qytetit, varrezat e dëshmorëve dhe varrezat e qytetit. / Lënda 01Nr. 104/02-13617/19.

6. Propozim Vendim për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 104/02-8061/19 të datës 29.03.2019- Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të ri shkollor në f. Doganaj

Kryesuesi i Kuvendit, Kur është dërguar Vendimi në MAPL, përmes kësaj drejtorie është dërguar në MPHMM, ndërkaq kjo ministri na ka dërguar një shkresë e cila iu bashkangjitur lëndës se lokacioni nuk është me PZHK. Plani zhvillimor komunal është në revidim e sipër dhe do të parashihet në atë lokacion shkollë, ndërkaq po të ishte me PZHK nuk ka pasur nevojë kjo çështje me dalë në KK. Iu njoftoj së çështja e ndërtimit të shkollës në atë lokacion është në procedurë e sipër, është shpallë tenderi dhe i njëjti është përmbyllur. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri nga anëtarët të cilët ishin prezent. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM

Për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 104/02-8061/19 të datës 29.03.2019- Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të ri shkollor në f. Doganaj / Lënda: 01Nr. 60/01-15086/19.

7. Propozim Vendimi për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 400/01-11745/19 i datës 30.04.2019- për transferin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2019 në kategorinë ekonomike, Paga dhe mëditje.

Kryesuesi i Kuvendit, Për sqarime të nevojshme fjalën e ka drejtori i DEFZH, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi- drejtor i DEFZH, Theksoj se Vendimi nga MAPL është miratuar i ligjshëm, mirëpo MEF ka kërkuar me ndryshuar, ashtu që në vendim më i shtuar edhe shumat në secilin kod buxhetor. Shumat i ka pasur Kërkesa e cila iu ka bashkangjitur Vendimit, mirëpo pa i bërë këto ndryshime MEF nuk po e bënë ekzekutimin e vendimit.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjuat sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 5 anëtarë, Abstenuan anëtarët: Afërdita Horuni dhe Ekrem Raka. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM

Për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 400/01-11745/19 i datës 30.04.2019- për transferin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2019 në kategorinë ekonomike, Paga dhe Mëditje / Lënda: 01Nr. 60/03-15077/19.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu në ora: 12:15 Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj mbledhjen të përfunduar. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 26 anëtarë, ndërkaq me arsye (shkaqe shëndetësore) me herët shkoi anëtarja, Hafize Sallahi.

Procesmbajtës
Makfite Malsiu

M Malsiu



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2017);

nga Mbledhja e V (Pestë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2019, mbajtur me 30.05.2019.

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma
4. Kadri Krivenjeva.....,
5. Besim Vishi.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Shurdhani.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku
12. Shpend Krusha.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Tafili
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Troni.....,
23. Afërdita Shehi.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka.....,



Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 27. 06. 2019

Për: Anëtarët e Kuvendit: **z. Ekrem Kyçyku**
znj. Afërdita Horuni
z. Adnan Reka
z. Besim Vishi

Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruara para Kuvendit të Komunës, më datë 30. 05. 2019, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Emergjencave dhe Shërbimeve Publike.

Ekrem Kyçyku,

Nga banorët e f. Llanishtë kam një kërkesë që të lidhen me rrugën "Mejdi Dalloshi", sepse lidhja më këtë rrugë është në të mirë të qytetarëve të asaj pjese.

- *Segmenti rrugor nga rr. "Mejdi Dalloshi" që shpie në drejtim të fshatit Llanishtë do të shqyrtohet në planifikimet e ardhshme të ekzekutivit të komunës. Aktualisht fshati Llanishtë ka rrugën e asfaltuar dhe banorët nuk kanë probleme në qarkullim.*

znj. Afërdita Horuni,

Pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve publike dhe Emergjencës; E dimë që shume herë është ngritur çështja e barrierave në rrugën "Emsale Frangu", mirëpo ende nuk keni ndërmarrë masa! Me intereson ta di, ku ka ngecë puna e kësaj çështje, pasi që rruga është shumë e kalueshme dhe është një pasiguri e madhe për fëmijët?

- *Vendosja e barrierave (policëve të shtrirë) në rrugën "Emsale Frangu" do të shqyrtohet nga zyrtarët kompetentë të komunikacionit. Pasi të kontraktujmë kompaninë për implementim të projektit "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal", planifikojmë që të vendosim barriera në afërsi të shkollave dhe shenjzime të venkalimeve për këmbësorë.*

Adnan Reka,

Periudha e Ramazanit ishte një sinjal i mirë për t'na treguar gjendjen e komunikacionit rrugor në qytet. Nuk jemi larg periudhës kur si zakonisht presim të na vijnë mërgimtarët tanë dhe të shtohet fluksi i veturave në komunikacion. Ne kërkojmë që të hartohet një Plan paraprak që të menaxhohet me kohë situata e parkingut dhe qarkullimit të lirë të veturave në Komunën e Kaçanikut.

- *Komuna ka caktuar hapësirën mbrenda Kalasë së Qytetit, hapësirën e Stacionit të autobusëve (pas orës 20h) dhe së fundmi për periudhën 3 mujore është lejuar nga DAK-ja edhe oborri i SHFMU "Emin Duraku" si vendparkingje shtesë për automjete. Jemi duke analizuar edhe hapësira tjera të mundshme për destinim*

parkingu në zonën urbane të qytetit, sidomos për periudhën kur të vijnë bashkëatdhetarët tanë nga diaspora.

z. Besim Vishi,

E kam një Kërkesë nga qytetarët e f. Dubravë, për vendosjen e policëve të shtrirë në rrugën e Dubravës, sepse po ka vozitje të shpejta, ndërkaq kemi kyçje në rrugë të shkolla dhe në lagjen Vishaj që nuk kanë asnjë pengesë në rrugë të cilët paraqesin rrezik për qytetarët e asaj ane.

2. Ndriçimi publik po bëhet nëpër rrugën kryesore të fshatit Dubravë, ndërkaq po e lënë pa ndriçim publik lagjen apo vendbanimin. Është mirë të ndërrohet qasja e projektit të ndriçimit publik, ashtu që ndriçimi publik të bëhet brenda lagjeve.

- *Pasi të kontraktosh kompaninë për implementim të projektit "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal", planifikojmë që të vendosim barriera (policë të shtrirë) në afërsi të shkollës dhe shenjzim të vendkalimeve për këmbësorë në rrugën "Beteja e 25 Majit"-Dubravë, kurse në rrugët e lagjeve do të analizohet paraprakisht arsyeshmëria dhe rrezikshmëria nga zyrtarët kompetent të kësaj lëmie.*
- *Prioritetet e komunës në këtë fazë janë ndriçimi i rrugëve kryesore të fshatrave dhe lagjeve të qytetit, kurse në fazat e mëvonshme do të analizohen edhe mundësitë për ndriçim të rrugëve dytësore. Por nëse komuniteti i një lagje të caktuar shpreh gatishmërinë për të implementuar projekte të ndriçimit me vetëfinancim, DSHPE-ja merr përsipër shpenzimet mujore të energjisë së shpenzuar elektrike, siq kemi vepruar në disa fshatra dhe lagje (lagjet: Dallosh, Kovaq, Topojani dhe Topalli-Soponicë, lagjet: Selman, Murseli dhe Kolshi- Doganaj)*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

Me respekt,

Ramadush Osmani

Drejtör i DSHPE-së